



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 354-8211 /2026

Datë: 30.03 /2026

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronjën b) dhe nenit 40. paragrafi 40.2 shkronjën c) dhe l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040. Nenit 10 pikën 4) dhe Nenin 40 pikën 11 të Statutit të Komunës së Klinës i miratuar në Mars 2010, me kërkesën e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të datës: 05.03.2026 me nr. prot-01Nr.06-6673/26 si dhe me Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 18.03.2026, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt për vitin 2026 të mbajtur me datë 27.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për realizimin e projektit për rindërtimin e sheshit në qendër të qytetit të Klinës, si ndërhyrje e domosdoshme infrastrukturore dhe urbane në funksion të përmirësimit të gjendjes ekzistuese.
2. Rindërtimi i sheshit do të realizohet në bazë të projektit detal, i cili u prezantua në Kuvend, dhe në përputhje me standardet teknike dhe profesionale në fuqi, duke përfshirë largimin e shtresës ekzistuese të kalldrëmit, rregullimin e nënshtresave, sistemimin e duhur të drenazhimit të ujërave atmosferike dhe ndërtimin e shtresës së re sipërfaqësore, me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit të hapësirës.
3. Ky projekt ka për qëllim përmirësimin e kushteve të qarkullimit për qytetarët dhe automjetet, eliminimin e problemeve ekzistuese infrastrukturore, përfshirë disnivelimet dhe dëmtimet në sipërfaqe, rritjen e sigurisë në komunikacion, si dhe ngritjen e standardit urban dhe estetik të qendrës së qytetit të Klinës, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e imazhit urban dhe cilësisë së jetës së qytetarëve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e cila është përgjegjëse për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme administrative, teknike dhe procedurale për realizimin e projektit, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës..
5. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

